



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5886 Prot.

Lezhë, më 31 . 03 . 2021

VENDIM

Nr. 56 Datë 30 . 03 . 2021

PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2021 DHE PBA 2021-2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/a-Të pakësohen shpenzimet në programin buxhetor “Rrjeti Rrugor Rural” në shumën 14,519,000 lekë për objektin: “Rehabilitim i qendrave të fshatrave Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldre, Gocaj e Blinsht”.

1/b-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Menaxhimi i Mbetjeve” në shumën 14,519,000 lekë.

Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.231 në shumën 14,519,000 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.05100, Kap.05, Art.602 në shumën 14,519,000 lekë.

2. Te shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Menaxhimi i Mbetjeve” në shumën 14,519,000 lekë për vitin 2022 në PBA 2021-2023 , të pakësohen shpenzimet në programin buxhetor “Rrjeti Rrugor Rural” në shumën 14,519,000 lekë për objektin “Investim për sistemimin e rrugëve urbane “ në vlerën 14 519 000 lekë.

3. Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor “Menaxhimi i Mbetjeve” në shumën 14,519,000 lekë për vitin 2023 në PBA 2021-2023 , te pakësohen shpenzimet në programin buxhetor “Rrjeti Rrugor Rural” në shumën 14,519,000 lekë për objektin “Investim për sistemimin e rrugëve urbane “ në vlerën 14 519 000 lekë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ